



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 347/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik-Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Kryesusesit të Komisionit të Vend Votimit, në Qendrën e votimit 2202E/02R , në Petrovë-Shtime, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e pa lejuar ankesa e subjektit politik-Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Bahri Rexhaj nga radhët e subjektit politik LDK, Kryesuses i Komisionit të Vend Votimit, në Qendrën e votimit 2202E/02R, në Petrovë-Shtime, për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.10.2019, subjektit politik-Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Bahri Rexhaj nga radhët e subjektit politik LDK, Kryesuses i Komisionit të Vend Votimit, në Qendrën e votimit 2202E/02R , në Petrovë-Shtime, në të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve në këtë Qendër të Votimit gjatë bartjes së votave për kandidatët mund të ketë gabim teknik.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit në Qendrën e Votimit 2202E/02R, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultatit i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrëhet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr. 347/2019 më datën 10.10.2019**

**Kryesues i Panelit**  
**Faton Ademi**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*